



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 5, datë 22.02.2017

P Ë R

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I KOLEKTORIT KRYESOR DHE IMPIANTIT TË UJRAVE TË
PËRDORURA NË ZONËN TURISTIKE GJIRI I LALËZIT, BASHKIA DURRËS”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i kolektorit kryesor dhe Impiantit të Ujrave të Përdorura në zonën turistike Gjiri i Lalëzit, Bashkia Durrës”, me zhvillues Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) miratimit të VKM-së dhe përfundimin e procedurave të shpronësimit;
 - b) miratimit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë;
 - c) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I


E D I R A M A



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



Egjanim



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

